



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE

DREJTORIA E PRONAVE PUBLIKE DHE MENAXHIMIT TË ASETETEVE

Nr. 12571 Prot

Vlorë, më 23.06 2026

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____ 2026

**“PËR SHPREHJEN E DAKORTËSISË PËR NISJEN E PROCEDURAVE PËR
TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË VLORE TË PASURISË ME NR.14/54,
ZONA KADASTRALE 8605”**

Në mbështetje të nenit 113 pika 1, shkronja “b” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Nenit 8, pika 2, të nenit 9, pika 1, nënpika 1.2, shkronja “c”, nenit 54 shkronja “e/1” të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; Ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar; Ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar; Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 500, datë 14.08.2001, “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendore”, të ndryshuar; Udhëzimit Nr.15, datë 30.05.2003, “Për mënyrën e paraqitjes nga Njësitë e Qeverisjes Vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike”; në shkresën nr.3845/1, datë 06.05.2026, të Ministrisë së Mbrojtjes, protokolluar në Bashkinë Vlorë me nr.5361/1, datë 08.05.2026 si dhe në relacionin bashkëlidhur këtij projektvendimi, paraqitur nga Administrata e Bashkisë, Këshilli i Bashkisë, në mbledhjen e tij të datës _____.06.2026,

VENDOSI:

1. Të shprehi dakortësinë për nisjen e procedurave për transferimin në pronësi të Bashkisë Vlorë, me qëllim realizimin e projekteve publike, të pasurisë truall me sipërfaqe 210.812m/2, ndodhur në zona kadastrale nr.8605, pasuria nr.14/54, sipas kartelës së pasurisë dhe hartës kadastrale bashkëngjitur.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari, Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve si dhe Drejtoria e Urbanistikës, të cilët do të kryejnë procedurat përkatëse ligjore deri në vendimarrjen e Këshillit të Ministrave për kalimin e pronësisë sipas pikës 1.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas parashikimeve të nenit 55/6 të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

KRYETAR
Brunilda Mersini





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
DREJTORIA E PRONAVE PUBLIKE DHE MENAXHIMIT TË ASETETEVE

Nr. 12571 Prot

Vlorë, më 23.06 2026

R E L A C I O N

**PËR PROJEKTVENDIMIN “PËR SHPREHJEN E DAKORTËSISË PËR NISJEN E
PROCEDURAVE PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË VLORE TË
PASURISË ME NR.14/54, ZONA KADASTRALE 8605”**

Të nderuar këshilltarë!

Në mbështetje të nenit 113 pika 1, shkronja “b” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Nenit 8, pika 2, të nenit 9, pika 1, nënpika 1.2, shkronja “c”, nenit 54 shkronja “e/l” të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar; Ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar; Ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar; Ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë; Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 500, datë 14.08.2001, “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendore”, të ndryshuar; Udhëzimit Nr.15, datë 30.05.2003, “Për mënyrën e paraqitjes nga Njësitë e Qeverisjes Vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike”; në shkresën nr.3845/1, datë 06.05.2026, të Ministrisë së Mbrojtjes, protokolluar në Bashkinë Vlorë me nr.5361/1, datë 08.05.2026, po ju parashtrojmë relacionin si më poshtë vijon:

Ky relacion hartohet me qëllim nisjen e procedurave për transferimin në pronësi të Bashkisë Vlorë, me qëllim realizimin e projekteve publike, të pasurisë së llojit “truall”, me sipërfaqe 210.812m/2, ndodhur në zonën kadastrale nr.8605, pasuria nr.14/54, pasuri pronë shtetërore e cila rezulton në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes.

Transferimi i kësaj pasurie në pronësi të Bashkisë Vlorë synon krijimin e mundësive për planifikimin dhe realizimin e projekteve publike në interes të komunitetit, në përputhje me dokumentet e planifikimit vendor dhe prioritetet e zhvillimit të Bashkisë Vlorë.

Pasuria objekt i këtij projektvendimi paraqet interes publik dhe përfshirja e saj në fondin e pronave të Bashkisë Vlorë do të mundësojë përdorimin e saj për investime publike dhe projekte zhvillimore që i shërbejnë qytetarëve.

Nisja e procedurave të transferimit të pronësisë është e nevojshme për t'i hapur rrugë ndjekjes së procedurave pranë institucioneve përgjegjëse shtetërore dhe për të siguruar administrimin e kësaj prone nga Bashkia Vlorë në funksion të interesit publik.

Miratimi i këtij projektvendimi nuk sjell efekte financiare të menjëhershme për buxhetin e Bashkisë Vlorë. Çdo investim apo projekt publik që do të realizohet në këtë pasuri do të trajtohet nëpërmjet procedurave dhe vendimmarrjeve përkatëse.

Për këtë qëllim, Bashkia Vlorë i është drejtuar zyrtarisht Ministrisë së Mbrojtjes, duke kërkuar nisjen e procedurave për kalimin në pronësi të saj të këtij objekti. Kërkesa është bazuar në objektivat e Bashkisë Vlorë e cila synon krijimin e mundësive për planifikimin dhe realizimin e projekteve publike në interes të komunitetit për ushtrimin normal të funksioneve administrative dhe publike. Ministria e Mbrojtjes, me shkresën nr.3845/1, datë 06.05.2026, ka shprehur dakortësinë për vijimin e procedurave për transferimin në pronësi të Bashkisë Vlorë të pasurisë objekt i këtij projektvendimi.

Nevoja për zhvillimin e projekteve publike lidhet ngushtë me rritjen e kërkesës për shërbime publike dhe me domosdoshmërinë e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së tyre në funksion të qytetarëve. Transferimi i kësaj pasurie në pronësi të Bashkisë Vlorë krijon mundësi konkrete për planifikimin dhe realizimin e investimeve me interes publik, duke garantuar një përdorim më efikas dhe të qëndrueshëm të territorit. Gjithashtu, kjo zgjidhje paraqitet si alternativa më e përshtatshme nga pikëpamja administrative, ekonomike dhe funksionale, pasi shmang kostot shtesë dhe procedurat e gjata që do të kërkoreshin për sigurimin e hapësirave të tjera, duke mundësuar realizimin në kohë të projekteve prioritare në shërbim të komunitetit.

Në kuadër të procedurës ligjore për transferimin e pronësisë së një pasurie të paluajtshme shtetërore në favor të një njësie të vetëqeverisjes vendore, kërkohet miratimi me Vendim të Këshillit të Ministrave. Përpara paraqitjes së kërkesës për miratim në Këshillin e Ministrave, legjislacioni në fuqi parashikon, ndër të tjera, edhe marrjen e Vendimit të Këshillit të Bashkisë për shprehjen e dakordësisë për kalimin e pronësisë, si dhe verifikimin e ligjshmërisë nga Prefekti i Qarkut Vlorë.

Në këtë kuptim, projektvendimi që paraqitet sot për miratim nuk nënkupton kalimin e menjëhershëm të pronësisë së pasurisë me nr. 14/54 në favor të Bashkisë Vlorë, por përbën një hap të domosdoshëm procedural, i cili i hap rrugë vijimit të mëtejshëm të praktikës pranë institucioneve kompetente. Janë këto institucione që do të shqyrtojnë dokumentacionin përkatës dhe do të vlerësojnë përmbushjen e të gjitha kritereve ligjore deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga Këshilli i Ministrave.

Referuar dispozitave ligjore që rregullojnë administrimin dhe transferimin e pasurive të paluajtshme, Këshilli i Bashkisë është organi kompetent për të shprehur dakordësinë për kalimin e pronësisë në favor të Bashkisë, duke qenë se bëhet fjalë për pasuri të paluajtshme që do të përdoren për funksione publike dhe administrative.

Për sa më sipër, duke vlerësuar rëndësinë strategjike që paraqet kjo pasuri për zhvillimin e projekteve publike dhe përmbushjen e objektivave të zhvillimit vendor, si dhe duke konsideruar dakordësinë paraprake të Ministrisë së Mbrojtjes për vijimin e procedurave të transferimit, gjykojmë se plotësohen kushtet për nisjen e procedurës ligjore për kalimin e saj në pronësi të Bashkisë Vlorë.

Miratimi i këtij projektvendimi përbën një hap të domosdoshëm procedural, i cili do t'i mundësojë Bashkisë Vlorë vijimin e praktikës pranë institucioneve kompetente shtetërore për shqyrtimin dhe miratimin përfundimtar të transferimit të pronësisë, sipas legjislacionit në fuqi.

Në këto kushte, duke pasur parasysh interesin publik që mbart kjo pasuri dhe nevojën për krijimin e hapësirave të nevojshme për realizimin e investimeve dhe projekteve në shërbim të komunitetit, kërkojmë nga Këshilli Bashkiak Vlorë miratimin e projektvendimit “Për shprehjen e dakordësisë për nisjen e procedurave për transferimin në pronësi të Bashkisë Vlorë të pasurisë së llojit truall me sipërfaqe 210.812 m², pasuria nr. 14/54, zona kadastrale nr. 8605”.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin dhe mbështetjen tuaj në funksion të interesit publik dhe zhvillimit të qëndrueshëm të territorit të Bashkisë Vlorë, ju ftojmë të votoni pro këtij projektvendimi.

DREJTOR
Bruna Bisholla





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

5361/1

08.05.2026

DATA

Nr. 3845/2 prot.

Tiranë, më 6.5.2026

Lënda: Mbi kërkesën tuaj për transferimin në pronësi të pasurisë 14/54, ZK8605, në Vlorë.

BASHKISË VLORË

Vlorë

Pasi u njohëm me shkresën tuaj nr. 5361 prot., datë 17.3.2026, nëpërmjet së cilës kërkonti dakordësinë për kalimin në pronësi të pasurisë 14/54, ZK 8605, e llojit "truall", me sipërfaqe totale 210.812 m², me qëllim përdorimi për realizimin e projekteve publike të cilat do të kenë një ndikim pozitiv për komunitetin për ndërtim banesash për kategoritë në nevojë, por edhe për nevoja të tjera që ka bashkia Vlorë, bëjmë me dije si vijon:

Referuar informacionit të dërguar struktura e Forcave të Armatosura, në zbatim të përcaktimeve të ligjit nr.64/2014, "Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, rezulton se pasuria nr. 14/54, ZK 8605, e llojit "truall", me sipërfaqe totale 210.812 m², identifikohet me pronën nr. 913, me emërtim "Aerodromi" në Vlorë, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, miratuar me VKM nr. 515, datë 18.07.2003, të ndryshuar.

Prona është jashtë Planit të Vendorsjes dhe Përhapjes së Forcave të Armatosura, dhe për të nuk ka plane zhvillimi afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, sipas legjislacionit për strategjinë dhe zhvillimin e Forcave të Armatosura.

Nisur nga sa më sipër, Ministria e Mbrojtjes shprehet paraprakisht parimisht dakord për vijimin e procedurave për transferim të pronës nr. 913, me emërtim "Aerodromi", në Vlorë.

Gjithashtu, ju bëjmë me dije gjithashtu se kjo pronë nuk i është nënshtruar procesit të përditësimit sipas VKM nr. 28, datë 27.01.2023, "Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve" dhe në këto kushte nuk mund të konfirmohet sipërfaqja e saktë dhe konfigurimi për të, pa u kryer ky proces.

Në përfundim, për të mundësuar vijimin e procedurave të mëtejshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi, për vetëqeverisjen vendore dhe pronat e paluajtshme të shtetit, kërkojmë të dërgoni pranë Ministrisë së Mbrojtjes, vendimmarrjen përkatëse të këshillit bashkiak, për pasurinë nr.14/54, me sipërfaqe 210812 m², e llojit "truall", ZK 8605, në Vlorë, si dhe projektin e miratuar të zhvillimit, ku të përcaktohet në mënyrë të plotë dhe të qartë qëllimi i përdorimit të pronës.

Faleminderit për mirëkuptimin.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
DREJTORI I DREJTORISË SË PËRGJITHSHME SË MODERNIZIMIT TË
KAPACITETEVE DHE ARMYTIMIT
Florenca Korbi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

Kodi Unik 8605064115
(Nga 8605062003, Në ____)

A - TË DHËNAT E PASURISË

Zona Kadastrale Nr. 8605, Lloji i Pasurisë: TRUALL, Nr. i Pasurisë: 14/54, Sipërfaqja Totale 210812 m²,
(Nga të Cilat Truall 210812 m²; Ndërtesë 0 m²)

Indeksi i Hartës Kadastrale VL-E-09, Numri i Pemëve: 0,

Adresa e Pasurisë: Bashkia Vlore, Rruga _____, Ndërtesa Nr. __, SH/K __, Apartamenti Nr. __

Vlera e Pasurisë:

Fillestare __ (Akti Nr. __, Dt. ____), Rivlerësim __ (Akti Nr. __, Dt. ____)

B – TË DHËNAT E TITULLIT TË PRONËSISË

Pronari: REPUBLIKA E SHQIPËRISË, Nr. Identifikimi/NIPT SG8530544756, Pjesa Takuese 1/1,
Lloji i Pronësisë: I

Adresa e Pronarit: Bashkia VLORE, Rruga _____, Ndërtesa Nr. __, SH/K __, Apartamenti Nr. __

Akti i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: _____, Nr. __, Datë: _____

Regjistruar: Nr. 00018364, Datë: 10/03/2022

**Pjesëmarrës në Bashkëpronësi të Detyrueshme për Pasurinë Nr. _____, me Kod Unik _____*

B/1 – TË DHËNAT E REGJISTRIMIT PARAPRAK

Akti Paraprak i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: _____, Nr. __, Datë: _____

Përshkrimi i Objektit të Aktit: _____

Regjistruar: Nr. __, Datë: _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHETËRËRE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

C-TË DREJTAT REALE

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i të Drejtës	Të Dhënat e Aktit			Afati i Vlefshmërisë	Përfitues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT
00018364	10/03/2022		NE PERGJEGJESI ADMINISTRIMI MINISTRISË SE MBROJTJES VKM 515 DT.18.07.2003			0		

D - KUFIZIMET E PRONËSISË

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i Kufizimit	Të Dhënat e Aktit			Afati i Kufizimit	Përfitues/Kërkues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT

E - INFORMACIONE TË TJERA PËR PRONËN

Lloji i Informacionit: _____, Emërtimi i Aktit: _____, Nr. _____, Datë: _____

Regjistruar: Nr. _____, Datë: _____

Përshkrimi:

DREJTORI
Albion Koçi

Arten
Nelaj

Digitally signed by:
Arten Nelaj
Date: 2026.04.02
09:20:16 +02'00'

Fatjon
Ferataj

Digitally signed by:
Fatjon Ferataj
Date: 2026.04.02
04:00:36 +02'00'

Albion
Koçi

Digitally signed by:
Albion Koçi
Date: 2026.04.03
08:20:38 +02'00'



Vulosur elektronikisht nga Drejtoria
Vendore Vlorë
Date: 2026/04/02 09:22:51 +02'00'
K5670320102026040209224379ASHK

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastrës)

REPUBLIKA E SHQIPERISE
AGJENCIA SHTETERORE E KADASTRES

FRAGMENT I HARTËS KADASTRALE

ZONA KADASTRALE : 8605

KODI UNIK : 8605064115

NUMRI I PASURISË : 14 / 54

INDEX I HARTES : VL - E - 10

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE



SH 1 : 25000

DREJTORI :
ALBION KOÇI

Fatjon Ferataj
Albion Koci

Digitally signed by:
Fatjon Ferataj
Date: 2026.05.04
04:14:17 +02'00'

Digitally signed by:
Albion Koci
Date: 2026.05.04
07:59:04 +02'00'

Data e leshimit : _____

SHPJEGUES :

☐ PARCELA
☒ NDERTESA



Vulosur elektronikisht nga Drejtoria
Vendore Vlorë
Date: 2026/05/04 16:17:16 +02'00'
K58703201O2026050416170978014

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Drejtoria Vendore Vlorë)